

TIRANE 2019

# PLANI STRATEGJIK 2019-2024

I UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS



**UNIVERSITETI  
POLITEKNIK  
I TIRANES**

Sheshi "Nënë Tereza",4  
Tiranë ALBANIA  
Tel: +355 4 2227914  
Web: [upt.al](http://upt.al)

MIRATOHET

Kryetari i Bordit te Administrimit



Arben DHIMA

# PLANI

# STRATEGJIK

# 2019-2024

I UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS

Tiranë 2019

## I. VIZIONI DHE MISIONI I UPT

### I.1 VIZIONI

Universiteti Politeknik i Tiranës (UPT) është Institucion Publik cilësor i arsimit të lartë dhe lider në fushat e tij të ekspertizës. Ai synon përsosjen dhe konsolidimin e formimit akademik dhe zgjidhjen e problemeve të rëndësishme kërkimore dhe shkencore në shkallë vendi dhe rajoni

### I.2 MISIONI

Misioni i UPT bazohet në ndershmërinë, kuriozitetin, krijimtarinë, lirinë e shpirtit, bashkëpunimin dhe transferimin e njohurive në fushën e shkencës dhe të edukimit për një zhvillim të qendrueshëm. UPT përhap njohuri, rrit dijet, promovon vlera humane dhe kulturë dialogu dhe drejtësi të gjithanëshme për rritjen e cilësisë së jetës duke synuar:

1. të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë e të mbrojë dijet me anën e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve si edhe të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj;
2. të ofrojë mundësi për të përfutuar nga arsimi i lartë gjatë gjithë jetës;
3. të ndihmojë zhvillimin ekonomik në nivel kombëtar dhe rajonal;

të kontribuojë në rritjen e standardeve të demokracisë e të qytetërimit të shoqërisë dhe në përgatitjen e të rinjve për një shoqëri të tillë.

## II. NDERKOMBETARIZIMI I UPT

### II.1 SYNIMET E NDERKOMBETARIZIMIT TE UPT

Synimet e nderkombetarizimit jane:

1. Rritja e njohjes ndërkombëtare të titujve universitarë të lëshuar nga UPT, në të gjitha ciklet e formimit.
2. Rritja e veprimtarisë ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor, nëpërmjet pjesëmarrjes në programet dhe projektet kërkimore kombëtare, Evropiane dhe rajonale dhe më gjerë.

3. Zgjerimi i bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e shkëmbimit të personelit akademik në të gjitha ciklet e formimit.
4. Intensifikimi i shkëmbimeve ndërkombëtare të studentëve në kornizën e programeve ndërkombëtare dhe marrëveshjeve dypalëshe.
5. Promovimi i formimeve dhe diplomave të përbashkëta me institucione homologe ndërkombëtare, kryesisht të ciklit të dytë dhe të tretë duke i dhënë në këtë mënyrë një vlerë të shtuar formimit dhe titujve universitarë të ciklit të parë, të lëshuar nga UPT.

## III. MENAXHIMI INSTITUCIONAL I UPT

### III.1 ZHVILLIMI I QENDRUESHEM I KAPACITETEVE NJEREZORE, FINANCIARE DHE INFRASTRUKTURE

#### III.1.1 Zhvillimi i Qendrueshem i Kapaciteteve Njerezore (ZH.Q.K.NJ.)

Universiteti Politeknik i Tiranës, synon të përgatisë specialistë me njohuri dhe aftësi inxhinierike të nevojshme për të përballuar sfidat e mëposhtme:

1. Zhvillimi i një sistemi kuadër të menaxhimit dhe lidërshiptit në të gjitha nivelet;
2. Zhvillimi i qendrueshëm i numrit të studenteve, që ndjekin programet e studimit të UPT në të gjitha ciklet e studimit.

UPT i konsideron me rëndësi jetike burimet njerëzore cilësore në të gjithë veprimtaritë e tij akademike dhe administrative.

1. UPT synon të përmirësojë politikat e rekrutimit të personelit akademik, duke u kthyer në një institucion që “punëson të zgjedhurit” me maksimumin e cilësisë së tyre.
2. UPT rrit dukshëm përpjekjet për të rekrutuar personel akademik me arritje të spikatura në fushën e tij profesionale, në arenën ndërkombëtare, sidomos duke rritur kujdesin për studentët shqiptarë që mbarojnë studimet jashtë vendit në IAL cilësore ndërkombëtare.
3. UPT synon një mjedis tërheqës dhe krijues për personelin e ri akademik duke përsosur mekanizmat për rritjen e mobilitetit të tyre dhe mbështetjen e tyre.
4. UPT synon maksimizimin e arritjeve të personelit të tij akademik.
5. UPT garanton mundësi të barabarta për zhvillimin e karrierës së personelit akademik të të gjitha niveleve si edhe të atij administrativ.

6. UPT nxit komunikimin për të gjithë personelin duke zhvilluar “praktikat më të mira” dhe përdorur mjetet më efektive, që rrisin performancën institucionale të tij.

### III.1.2 Zhvillimi i Qendrueshem i Kapaciteteve Financiare (ZH.Q.K.F.)

UPT synon të realizojë objektivat e tij, në këtë fushë si vijon:

1. rritja e autonomisë në politikën e menaxhimit;
2. rritja e të ardhurave të UPT nëpërmjet veprimtarive në fushat e tij të ekspertizës.

### III.1.3 Zhvillimi i Qendrueshem i Kapaciteteve Infrastrukturore (ZH.Q.K.I.)

UPT për ZH.Q.K.I. synon :

1. menaxhim më efikas i mjediseve të tij;
2. përmirësimin e standardit të raportit m<sup>2</sup>/student;
3. zhvillimin e qendrueshëm të infrastrukturës bibliotekare në nivel institucional dhe për cdo njësi përbërëse të tij;
4. zhvillimin e qendrueshëm të bazës laboratorike dhe pajisja e tyre me teknologjitë moderne të informacionit;
5. përmbushjen e standardeve për sigurinë e jetës dhe shëndetit dhe mbrojtjes së mjedisit;
6. përmirësimin e mjediseve sportive dhe të shërbimeve për studentët dhe personelin e tij.

## IV. MENAXHIMI I PROCESIT TE MESIMDHENIES NE UPT

### IV.1 UPT SYNON PËRMIRËSIMIN E KULTURËS SË CILËSISË NË PROCESIN E EDUKIMIT NËPËRMJET ZBATIMIT TË STANDARTEVE MË TË PËRPARUARA

UPT zhvillon dhe zbaton mekanizma për promovimin dhe zotërimin e një kulture të cilësisë në të gjitha njësitë dhe të gjitha nivelet, zhvillimin e procedurave për monitorimin

dhe rishikimin e cilësisë akademike, rritjen e cilësisë në qeverisje dhe menaxhimin e institucionit, me synim rritjen e cilësisë në të gjitha programet e studimit që ofron.

#### IV.2 REFORMIMI NË BAZË TË REZULTATEVE TË TË MËSUARIT DHE ME QENDËR STUDENTIN

UPT synon modernizimin dhe zhvillimin e qendrueshëm të programeve të studimit në të tre ciklet që ajo ofron mbi bazën e tri shtyllave kryesore:

1. vendosjes së studentit në qendër të procesit të mësimdhënies dhe të asimilit ;
2. zhvillimit të programeve të studimit në bazë të rezultateve të të mësuarit , konform standardeve kombëtare dhe Evropiane;
3. orientimit të programeve të studimit ndaj kërkesave të tregut të punës.

#### IV.3 VLERËSIMI PERIODIK I PROGRAMEVE TË STUDIMIT DHE AKREDITIMI I TYRE

UPT synon akreditimin e programeve të studimit nëpërmjet zhvillimit kurrikular cilësor jo vetëm në nivel kombëtar, por edhe rajonal duke plotësuar standardet shtetërore për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit.

#### IV.4 RITJA E CILËSISË NË PRAKTIKA PROFESIONALE DHE DIVERSIFIKIMI I TYRE

UPT synon zhvillimin e aftësive praktike të studentëve, me fokus në zhvillimin efikas të praktikave profesionale për ta. Ai nxit dhe mbështet krijimtarinë e studentëve në partneritet të plotë me biznesin dhe mbi bazën e shanseve të barabarta dhe zgjerimin e internshipit.

#### IV.5 ZHVILLIMI I INFRASTRUKTURËS DIXHITALE PËR PËRMIRËSIMIN E EDUKIMIT DHE KRIJIMIN E OPORTUNITETEVE PËR PERSONELIN AKADEMIK

UPT synon zhvillimin e qendrueshëm të metodave dhe metodikave në mësimdhënie duke u mbështetur në teknologjitë e reja të komunikimit dhe zhvillimit dhe u krijuar të gjitha mundësitë personelit akademik për të përshtatur dhe për t'u zhvilluar në përputhje me to. UPT synon për të qenë një IAL lider në drejtim të përdorimit të IT në të gjithë veprimtarinë e tij duke mbështetur përpjekjet për zhvillimin e infrastrukturës dixhitale në shërbim të mësimin me pikësynim rritjen e përdorimit të software për zhvillim profesional të personelit akademik dhe të studentëve.

## IV.6 ZHVILLIMI I QENDRUESHËM I CILËSISË SË PRANIMEVE NË TË GJITHË PROGRAMET E STUDIMIT TË UPT

UPT synon promovimin i imazhit të tij në rekrutimin e studentëve nëpërmjet formave të ndryshme duke përfshirë edhe organizimin e Ditës së Hapur për UPT. Vendosija e konkurseve specifike të pranimit me pikësnyim seleksionimin e kandidatëve me karakteristikat më të mira e në përshtatje me programet përkatës të studimit.

## IV.7 FUQIZIMI I NISMAVE MBËSHTETËSE PËR TË NDIHMUAR SUKSESIN PROFESIONAL DHE FUTJEN E TË DIPLOMUARVE NË TREGUN E PUNËS

UPT synon :

1. monitorimin e vazhdueshëm të tregut të punës;
2. organizimin i moduleve të veçanta për forcimin e aftësive dhe të njohurive të studentëve për të lehtësuar futjen e tyre në tregun e punës;
3. mbështjetjen për studentët jo vetëm për gjuhë të huaja, por edhe për lëndët ekstrakurrikulare, si dhe për çdo nisëm që çon në lehtësimin e punësimit të tyre.
4. organizimin e panairove të punës, në të cilët të inkurajohen kontaktet punëdhënës-punëmarrës për të lehtësuar futjen në tregun e punës të të sapodiplomuarve.

# V. MENAXHIMI I KËRKIMIT SHKENCOR NE UPT

## V.1 ZHVILLIMI I BURIMEVE NJERËZORE, I KAPACITETEVE INFRASTRUKTURE DHE FINANCIARE NË SHËRBIM TË KËRKIMIT SHKENCOR DHE SHËRBIMEVE NË UPT

Për plotësimin e këtij objektivi synohet:

1. ruajtja dhe zhvillimi i burimeve njerëzore për të garantuar vazhdueshmërinë e kërkimit shkencor në UPT;
2. rritja e fondeve për kërkimin shkencor dhe shërbimet në rang institucional;
3. përmirësimi i infrastrukturës së kërkimit shkencor nëpërmjet ngritjes së laboratorëve të rinj;
4. modernizimi i bibliotekave shkencore të fakulteteve për t'i kthyer në një burim të vlefshëm e të domosdoshëm informacioni në shërbim të kërkimit shkencor dhe zgjerimit të njohurive për studentët.

## V.2 RITJA NË SASI DHE CILËSI E VEPRIMTARISË KËRKIMORE DHE E SHËRBIMEVE NË MBËSHTETJE TË PRIORITETEVE STRATEGJIKE TË ZHVILLIMIT TË VENDIT.

Për plotësimin e këtij objektivi synohet:

1. bashkëpunimi me institucionet publike dhe organizmat qeveritare me qëllim kontributin për trajtimin e problematikës që lidhen me zhvillimin perspektiv të vendit për përballimin e sfidave në drejtim të një zhvillimi të qëndrueshëm;
2. fuqizimi i kapaciteteve krijuese të personelit akademik e kërkimor të UPT nëpërmjet inkurajimit të lirisë kërkimore për të adresuar çështje me rëndësi shkencore në shërbim të zhvillimit të vendit;
3. zhvillimi i kërkimit shkencor bazë dhe të zbatuar në gjithë fushat inxhinierike që mbulon UPT;
4. zhvillimi i një klime bashkëpunimi me institucione të tjera publike dhe private brenda vendit që operojnë në fushat përkatëse inxhinierike;
5. bashkëpunimi me sektorin privat për të mundësuar dhënien e ekspertizës dhe zgjidhjen e probleme teknike e teknologjike që hasen;
6. zhvillimi i kërkimit shkencor në UPT në përputhje me standartet e cilësisë.

## V.3 RITJA E KONTRIBUTIT TË KËRKIMIT SHKENCOR NË PËRMIRËSIMIN CILËSOR TË OFERTËS AKADEMIKE NË TË TRE CIKLET E STUDIMIT

Për plotësimin e këtij objektivi synohet:

1. një thellim i integritit të kërkimit shkencor me mësimdhënien nëpërmjet angazhimit të studentëve të nivelit Master dhe Doktoratë në projekte studimore e kërkimore me qëllim kultivimin tek këta të fundit të shprehive të kërkuesit e studjuesit të integruar në grup si dhe të ofrimit të kapaciteteve cilësore laboratorike dhe të vëzhgimit e eksperimentimit në terren;
2. sigurimi dhe promovimi i lidhjeve të vazhdueshme me institucionet dhe universitetet homologe Evropiane dhe më gjerë përmes marrëveshjeve të qëndrueshme të bashkëpunimit dhe projekteve të përbashkëta në fushat me interes të përbashkët në shërbim të kualifikimit shkencor, doktoratave, postdoktoratave, dhe shkëmbimi i eksperiencave në këto fusha;
3. përfshirja e studentëve në kërkimin shkencor, për të kontribuar në formimin e tyre profesional, rritjen e shkallës së përvetësimit të programeve mësimore, orientimin e tyre në tregun e punës, inicimin e tyre si kërkues të ardhshëm si dhe për të realizuar objektivat e kërkimit.



#### V.4 FORCIMI I ROLIT TË INSTITUTIT TË GJEOSHKENCAVE, ENERGJISË, UJIT DHE MJEDISIT SI NJËSI KRYESORE KËRKIMORE E EKSELENCËS NË FUSHAT PËRKATËSE TË EKSPERTIZËS.

Për plotësimin e këtij objektivi synohet:

1. mbështetja për realizimin e një projekti Evropian për strategjinë e zhvillimit të Institutit në bashkëpunim dhe partneritet me institucionet homologe;
2. forcimi i një bashkëpunimi të qëndrueshëm me njësitë kryesore të UPT me pjesëmarrjen e personelit akademik në kërkimin shkencor dhe, anasjelltas, të punonjësve kërkimorë në mësimdhënie;
3. integrimi i praktikave mësimore dhe profesionale të studentëve në veprimtarinë e institutit;
4. zhvillim i qëndrueshëm i karrierës dhe shkëmbimi i praktikave më të mira në institucionet partnere dhe më gjerë dhe transmetimi i atyre përvojave në mësimdhënie.

#### V.5 EVIDENTIMI DHE PËRHAPJA E REZULTATEVE TË KËRKIMIT SHKENCOR BAZË DHE TË ZBATUAR QË ZHVILLOHET NË UPT

Për plotësimin e këtij objektivi synohet:

1. një administrim më i mirë i kërkimit shkencor nëpërmjet krijimit të bazave të të dhënave dixhitale, lehtësisht të përdorshme si dhe inventarizim më të mirë të pasurive shkencore të UPT;
2. bërja publike e të gjithë projekteve të financuara, në kuadrin e programeve kombëtare dhe ndërkombëtare të kërkim zhvillimit për një shfrytëzim sa më të gjerë të informacionit shkencor;
3. publikimi i rezultateve të kërkimit shkencor në revista të njohura si brenda ashtu edhe jashtë vendit.

#### V.6 RITJA E KONTRIBUTIT TË KËRKIMIT SHKENCOR, VEPRIMTARIVE KRIJUESE DHE EKSPERTIZËS NË FUSHAT PËRKATËSE INXHINIERIKE NË SIGURIMIN E TË ARDHURAVE SUPLEMENTARE PËR UPT

Për plotësimin e këtij objektivi synohet:

1. pjesëmarrje aktive në projektet e financuara nga AKKSHI;
2. krijimi i të ardhurave nga veprimtaritë kërkimore-shkencore, nga të drejtat intelektuale, nga markat dhe patentat, nga shërbimet, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
3. një pjesëmarrje më e gjerë në ekspertiza e konsulencë, duke i konsideruar si elementë jo vetëm të afirmimit profesional e shkencor.

## VI. MENAXHIMI I JETES STUDENTORE NE UPT

### VI.1 PËRMIRËSIMI I CILËSISË SË JETËS STUDENTORE DUKE SYNUAR RRIJTJEN E CILËSISË SË SHËRBIMEVE SI DHE ZBATIMIN E NJË POLITIKE GJITHPËRFSHIRËSE SI NË VENDIMARRJE ASHTU DHE NË ZHVILLIMIN SHOQËROR PËR STUDENTËT

#### VI.1.1 Përmirësimi dhe rritja e cilësisë së shërbimeve ndaj studentëve, duke krijuar një kulturë shërbimi cilësor bashkohor, që synon:

1. përmirësimin dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve ndaj studentëve nëpërmjet informimit, këshillimit, mbështetjes si dhe orientimit të tyre;
2. përmirësimin dhe krijimin e një infrastrukture të përshtashme dhe funksionale në shërbim të studentëve.

#### VI.1.2 Përmirësimi dhe zbatimi i një politikë gjithpërfshirëse si në vendimarrje ashtu edhe në zhvillimin e veprimtarisë shoqërore nëpërmjet:

1. përmirësimin dhe rritjen e rolit të studentëve në proceset e vendimmarrjes,
2. përmirësimin të politikës gjithpërfshirëse të zhvillimit shoqëror, për studentët.

### VI.2 PËRMIRËSIMI I CILËSISË SË SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË INFORMACIONIT NË NIVEL INSTITUCIONAL

UPT angazhohet për përmirësimin e cilësisë së sistemit të menaxhimit të informacionit në nivel institucional, duke synuar paraqitje të plotë, të qartë, të saktë e të përditësuar të informacionit për studentët që lidhet me veprimtarinë e UPT-së, veçanërisht me procesin mësimor. Mirëfunksionimi i sistemit të menaxhimit të informacionit në nivel institucional u mundëson studentëve kontaktin me tutorin, për të garantuar të drejtat e tyre dhe monitorimin e problemeve të mundshme.

### VI.3 FUNKSIONIMI DHE PËRDORIMI I KARTËS SË STUDENTIT

UPT angazhohet për përmirësimin e cilësisë së jetës studentore nëpërmjet:

1. ofrimit të shërbimit të kartës së studentit në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës.

## VI.4 PËRMIRËSIMI DHE ZBATIMI I NJË POLITIKË GJITHPËRFSHIRËSE SI NË VENDIMARRJE ASHTU EDHE NË ZHVILLIMIN E VEPRIMTARISË SHOQËRORE

**VI.4.1 UPT angazhohet për përfshirjen dhe pjesëmarrjen aktive të studentëve në proceset e vendimmarrjes, mbështetet në veprimtarinë e Këshillave Studentore fokusuar në objektivin parësor atë të përmirësimit të cilësisë në UPT**

Për plotësimin e këtij objektiivi do të synohet:

1. riorganizimi i Këshillave Studentore;
2. krijimi i infrastrukturës së përshtatshme për Këshillat Studentore, në mjediset e njësive kryesore.

**VI.4.1 Përmirësimi i politikës gjithpërfshirëse të zhvillimit shoqëror, për studentët.**

UPT është e angazhuar për përmirësimin dhe zbatimin e një politike gjithpërfshirëse të zhvillimit shoqëror për studentët, e cila synon në rritjen e veprimtarive shoqërore të studentëve jashtë auditorëve, duke ndikuar në përmirësimin e cilësisë të jetës universitare.

# PLANI I VEPRIMIT PER ZBATIMIN E STRATEGJISE 2019-2024 NE UPT

## II NDËRKOMBËTARIZIMI

### II.1 Veprimtaritë e UPT për zbatimin institucional të ndërkombëtarizimit

Për plotësimin e këtij objektivi synohet:

1. Krijimi i stimujve për promovimin dhe mbështetjen e bashkëpunimit ndërkombëtar në nivel njësie bazë nëpërmjet dhënies së çmimeve/ shpërblimeve vjetore nga Rektori për personelin akademik dhe studentët, që kanë dhënë kontribut të shquar në promovimin e UPT në arenën ndërkombëtare.
2. Mbështetje institucionale për rritjen e vazhdueshme të numrit të profesorëve të huaj të përfshirë në veprimtaritë mësimdhënëse dhe kërkimore të UPT.
3. Intensifikimi i bashkëpunimit shkencor me partnerët homologë ndërkombëtarë (konferenca të përbashkëta, projekte, etj), për rritjen e njohjes ndërkombëtare të veprimtarive akademike të UPT. Inkurajimi dhe rritja e pjesëmarrjes nga njësitë bazë dhe kryesore të UPT në programet Evropiane të bashkëpunimit Erasmus plus, H2020 dhe më gjerë (objektivat e zyrave të UPT).
4. Promovimi i botimeve kërkimore në gjuhë të huaja në buletin e botuar nga UPT për të rritur faktorin e tyre të ndikimit në arenën ndërkombëtare.
5. Forcimi dhe zgjerimi i bashkëpunimit shkencor dhe i kërkim-zhvillimit të UPT me qendrat kërkimore jo universitare jashtë dhe brenda vendit.
6. Nxitja institucionale për rritjen e numrit të programeve të përbashkëta të studimit kryesisht të ciklit të dytë dhe të tretë me partnerë ndërkombëtarë.
7. Përmirësimi i vazhdueshëm i menaxhimit të veprimtarive të Zyrës së Bashkëpunimit Ndërkombëtar të UPT dhe krijimi i një pike qendrore të shërbimit për studentët e huaj pranë saj.

8. Përmirësimi i vazhdueshëm veprimtarisë së personelit administrativ nëpërmjet nxitjes dhe rritjes së pjesëmarrjes së tyre në bashkëpunimin ndërkombëtar.
9. Inkurajimi i pranimit të studentëve të huaj shqipfolës në formimet e propozuara nga UPT me pikësynim zgjerimin e pranimeve në formimet e përbashkëta me partnerë ndërkombëtarë dhe në gjuhë të huaja.
10. Përmirësimi i vazhdueshëm i mënyrës së komunikimit brenda dhe jashtë UPT nëpërmjet përdorimit të teknologjive të reja të komunikimit dhe informimit.

**Tabela e vënies në jetë të ndërkombëtarizimit**

Ref	Emërtimi	Indikatori	Afati	Struktura përgjegjëse	Burimet		Rreziqet
					njerëzore	Financiare (Lekë)	
II.1	<b>Veprimtaritë e UPT për zbatimin institucional të ndërkombëtarizimit.</b>						
	1. Krijimi i stimujve për promovimin dhe mbështetjen e bashkëpunimit ndërkombëtar nëpërmjet dhënies së çmimeve/ shpërblimeve.	Nr. i çmimeve/ shpërblimeve për vit	2020 – në vijim	Rektorati	DBNJ	250 000 Lekë	Kufizimet buxhetore
	2. Mbështetje institucionale për rritjen e vazhdueshme të numrit të profesorëve të huaj .	Nr. i mobiliteteve për vit	2019 – në vijim	Rektorati	DBNJ	1 250 000 Lekë	Kufizimet buxhetore
	3. Intensifikimi i bashkëpunimit shkencor me partnerët homologë ndërkombëtarë	Nr. i veprimtarive të përbashkëta / vit	2019 – në vijim	Rektorati Njësitë kryesore dhe bazë.	Njësitë bazë	-	-
	4. Promovimi i botimeve kërkimore në	Nr. i botimeve në gjuhë të huaj / vit	2019	Njësitë bazë të UPT	Grupet kërkimore	-	-

gjuhë të huaja nga UPT.  5. Forcimi dhe zgjerimi i bashkëpunimit shkencor R&D në UPT me qendrat kërkimore jo universitare jashtë dhe brenda vendit	Nr. i veprimtarive dhe projekteve të përbashkët / vit	2020	Njësitë bazë të UPT	Grupet kërkimore	1 250 000 Lekë	Kufizimet buxhetore
6. Nxitja institucionale për rritjen e numrit të programeve të përbashkëta të studimit kryesisht të ciklit të dytë dhe të tretë me partnerë ndërkombëtarë	Nr. i programeve të përbashkët ose të delokalizuar përbashkët / vit	2019	Njësitë kryesore të UPT	Njësitë bazë të UPT	-	-
9. Inkurajimi i pranimit të studentëve të huaj shqipfolës në formimet e propozuara nga UPT	Nr. I studentëve të huaj shqipfolës	2019	Rektorati i UPT	Njësitë kryesore dhe bazë të UPT	-	-

### III MENAXHIMI INSTITUCIONAL

#### III.1 Zhvillimi i vazhdueshën i kapaciteteve njerëzore

Plani i veprimit për realizimin e këtij objekti konsiston në:

1. krijimin e mundësive për kualifikimin dhe specializimin e mëtjshëm, me qëllim rritjen dhe zhvillimin profesional të personelit akademik dhe administrativ.
2. intensifikimin e marrëdhënieve të shkëmbimit të personelit të UPT me universitetet perëndimore dhe më gjerë.
3. rishikimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të procedurave të rekrutimit dhe seleksionimit të personelit akademik dhe administrativ.

4. përmirësimin e sistemit të menaxhimit të performancës dhe motivimit të personelit të UPT.

### III.2 Zhvillimi i kapaciteteve financiare

Në planin e veprimit për zhvillimin e kapaciteteve financiare synohet në:

1. rritjen e sasisë dhe tipologjisë së shërbimeve dhe infrastrukturës, që gjeneron të ardhura;
2. rritjen e peshës specifike të investimeve me financim të huaj;
3. intensifikimin e punës për përthithjen e donacioneve;
4. ngritjen e Qendrës së Shërbimeve ndaj të Tretëve, e parashikuar në PBA 2019 – 2020;
5. informatizimin e plotë të menaxhimit financiar.

### III.3 Zhvillimi i kapaciteteve infrastrukturore

Në planin e veprimit për zhvillimin e kapaciteteve infrastrukturore synohet:

1. menaxhimi i informatizuar i mjediseve akademike me pikësynim menjanimin maksimal të hapësirave bosh në orarin e veprimtarisë studentore.
2. përmirësimi i standardit të raportit m<sup>2</sup>/ student duke synuar një standard mesatar Evropian.
3. rritja e hapësirave bibliotekare në nivel institucional dhe njësie kryesore.
4. planifikimi institucional i zhvillimit të qendrueshëm të bazës laboratorike sipas njësive kryesore dhe bazë të UPT.
5. realizimi i standardeve kombëtare për sigurinë e jetës dhe të shëndetit në punë në përputhje me specifikat e UPT dhe normave mjedisore.
6. planifikimi dhe realizimi i zhvillimit të qendrueshëm të hapësirave të shërbimit dhe veprimtarive sportive për studentët dhe personelin e UPT.

**Tabela e vënies në jetë të menaxhimit institucional**

Ref	Emërtimi	Indikatori	Afati	Struktura përgjegjëse	Burimet		Rreziqet
					njerëzore	Financiar e (lekë)	
III.1	Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore			Rektorati.		-	

	1. Kualifikimi në vijimësi i personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ.	Nr. i marrëveshjeve të bashkëpunimit me synim trajnimin e personelit akademik dhe jo akademik.	2023 – në vijim		DKSH, DBNJ.		Ndryshimi i prioriteteve të BE.
	2. Përmirësim i procedurave të rekrutimit.	Nr. i mobile-oteteve për personelin.	2019	DBNJ, DSBC, DBNJ.	DBNJ.	-	-
	3. Përmirësim i sistemit të performancës dhe motivimit.	Miratimi i procedurave të rishikuara të rekrutimit. Miratimi i sistemit të vlerësimit të performancës.	2019 2019	DSBC, DBNJ.	DSBC, DBNJ. DSBC, DBNJ.	- -	Mosmiratimi në Senat. Mosmiratimi në Senat.
<b>III. 2</b>	<b>Zhvillimi i kapaciteteve financiare.</b>						
	1. Planifikimi dhe zbatimi i investimeve që gjenerojnë të ardhura.	Rritja në % e investimeve që gjenerojnë të ardhura.	2023	Rektorati	Njësitë bazë, Njësitë kryesore, Sektori IM.	Mesatarisht 18 000 000 Lekë / vit.	Korniza ligjore. Mosmiratimi në Senat dhe Bord i planit. Efikasiteti i ulët në prurjen e fitimeve.
	2. Rritje e investimeve me financim të huaj.	Rritja në % kundrejt buxhetit total.	2023	Rektorati	Njësitë Kryesore, bazë, DKS H, Sektori IM, DE.	100 000 Lekë / vit.	Mos përfitimi i investimeve me financim të huaj.
	3. Angazhimi për përthithjen e donacioneve.	Miratimi i plan programit për përthithjen e donacioneve.	2020	Administratori i UPT	DE, Sektori IM.	1 400 000 Lekë / vit (të paktën)	Mungesa e interesit të donatorëve.
	4. Ngritje e Njesisë së Shërbimeve ndaj të Tretëve.	Licensa për Ngritjen e Njesisë për Shërbime ndaj të Tretëve.	2023	Senati Akademik, Bordi Administrimit	Rektorati i UPT.	Kosto mirëmbajtjeje prej 5 000 000 ekë / vit.	Korniza Ligjore për licensimin.
						-	



	5. Menaxhim financiar i informatizuar.	Nr. Kontratave me të tretët.  Funksionimi i Platformës së Kontabilitetit.	2020  2020	Administratori i UPT.	DE, Sektori IT.		Mosrealizimi i projektit sipas marrëveshjes nga RASH.
<b>III.3</b>	<b>Zhvillimi i kapaciteteve infrastrukturor e.</b>						
	1. Menaxhim i integruar i ambienteve dedikuar procesit mësimor dhe kërkimor shkencor.	Funksionimi i integruar i mjediseve sipas godinave të UPT në mënyrë të informtizar.	2023	Drejtorja e Kurrikulave, Administratori i UPT.	Njësitë kryesore, DSHB.	17 000 000 Lekë	Mosrealizimi në kohë i procedurave për arsye të kornizës ligjore.
	2. Raporti m <sup>2</sup> /student	7.6 m <sup>2</sup> /student	2023	Senati Akademik, Bordi i Administrimit	Rektorati i UPT, Njësitë bazë.	Nuk ka efekte financiare	Ndryshimi i prioriteteve të qeverisë për programet.
	3. Rritje e hapësirave bibliotekare.	Vënia në funksionim e sallave të reja multimediale.	2023	Rektorati i UPT.	Dekanatet e FAU, FIMIF, FTIdhe FIE. DSHB, Sektori IM dhe DE.	139 462 000 lekë.	Mosrealizimi në kohë i procedurave për arsye të kornizës ligjore.
	4. Zhvillimi i qëndrueshëm i bazës laboratorike.	% e investimit për bazë laboratorike kundrejt buxhetit total.	2021	Rektorati i UPT.	Njësitë Kryesore dhe bazë. Sektori IM, DSHB, DE.	10% e buxhetit total 14% e buxhetit total	Vlera e Grantit nga Buxheti i Shtetit për financimin e investimit. Korniza ligjore për prokurimin publik.
	5. Plotësimi i standardeve infrastrukturor e për sigurinë e jetës dhe shëndetit.	Rehabilitimi strukturor i ndërtesave të vjetra të UPT: 1) Shtesat Anësore të Korpusit Qendror, 2)	2023	Administratori i UPT.	Sektori IM.	150 480 845 Lekë me TVSH.	Mosmiratimi në organet Kolegjiale Mosrealizimi në kohë i procedurave për arsye të

		Ndërtesa e FIMIF, 3) Ndërtesa e vjetër e FIN dhe FAU.					kornizës ligjore.
6. Plotësimi me hapsira shërbimi		Ambiente shërbimi kancelarie për çdo njësi.	2021	Administratori i UPT.	Njësitë Kryesore	5 000 000 Lekë / vit.	Mosrealizimi në kohë i procedurave për arsye të kornizës ligjore.
			2023	Administratorii UPT.	Spektori IM, DSHB, DE.	-	
7. Planifikimi i hapësirave sportive.		Projekti për ambiente sportive.	2023	Administratorii UPT.	Spektori IM. Administratorii UPT.	-	

#### IV MENAXHIMI I PROCESIT TË MËSIMDHËNIES NË UPT

##### IV.1 UPT synon përmirësimin e kulturës së cilësisë në procesin e edukimit nëpërmjet zbatimit të standarteve më të përparuara

Plani i veprimeve për arritjen e këtij synimi konsiston në:

1. plotësimin dhe modernizimin e strukturës dhe sistemit të sigurimit të cilësisë në UPT nëpërmjet ristrukturimit të qendrës së cilësisë dhe organizimit të rrjetit të cilësisë deri në nivel programi studimi
2. zhvillimin e kapaciteteve për monitorimin dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë në procesin e edukimit.
3. përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të sigurimit të cilësisë me synim rritjen e efektivitetit dhe efijencës së programeve të studimit.
4. rritja e transparencës dhe futja e metodës së vetëvlerësimit periodik të punës së personelit akademik si pjesë e rritjes së kulturës së cilësisë.
5. zbatimi i planit të veprimeve për përmbushjen e rekomandimeve të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm Institucional për arritjen e afatit maksimal të akreditimit institucional të UPT

##### IV.2 Reformimi në bazë të rezultateve të të mësuarit dhe me qendër studentin

Plani i veprimeve për arritjen e këtij synimi konsiston në:

1. rishikimin dhe përmirësimin e programeve të studimit duke u mbështetur tek rezultatet e të mësuarit (Learning Outcomes - LO).
2. realizimi i studimit të kërkesave të tregut të punës në fushat e veprimtarisë së UPT.
3. ridimensionimi i rolit të studentëve duke e vendosur në qendër të procesit të mësimdhënjes dhe të asimilimit.
4. nxitja e metodave moderne dhe efektive të zhvillimit të disiplinave që japin rezultate positive për studentët.
5. reformimi i programeve të lëndëve duke harmonizuar formimin teoriko-shkencor me aftësimin praktik dhe atë të sipërmarrjes të studentët.

#### **IV.3 Vlerësimi periodik i programeve të studimit dhe Akreditimi i tyre**

Për plotësimin e këtij objektivi synohet:

1. forcimi i rolit të biznesit dhe Alumnit në përmirësimin e programeve të studimit.
2. përmirësimi i procesit të informimit të studentëve dhe stafit me informacion të përditësuar, në kohë reale.
3. planifikimi, realizimi dhe ndjekja i procesit të vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit.
4. matja e shkallës së plotësimit të pritshmërive të studentit në nivel program studimi.
5. menaxhimi i të dhënave, përmirësimi i sistemit të informimit, komunikimit dhe promovimi i rezultateve më të mira.
6. ruajtja, tranferimi dhe menaxhimi i njohurive institucionale të përftuar nga eksperiencia dhe aktiviteti i personelit akademik të brendshëm dhe të jashtëm.

#### **IV.4 Rritja e cilësisë në praktika profesionale dhe diversifikimi i tyre**

Për plotësimin e këtij objektivi synohet:

1. hartimi i një plani të zhvillimit të aftësive praktike të studentëve për cdo program studimi, me fokus në zhvillimin efiçient të praktikave profesionale për studentët.
2. zgjerimi i internship për studentët e UPT.

3. rritja e bashkëpunimit me biznesin dhe Alumnin për realizimin e praktikave profesionale të studentëve.

#### **IV.5 Zhvillimi i infrastrukturës dixhitale për përmirësimin e edukimit dhe krijimin e oportuniteteve për personelin akademik**

Për plotësimin e këtij objektivi synohet:

1. shtrirja dhe përdorimi i IT në të gjithë aktivitetet e UPT.
2. zhvillimi i infrastrukturës dixhitale në shërbim të mësimit, duke synuar rritjen e përdorimit të software për zhvillim profesional të personelit akademik dhe të studentëve.

#### **IV.6 Zhvillimi i qendrueshëm i cilësisë së pranimeve në të gjithë programet e studimit të UPT**

Për plotësimin e këtij objektivi synohet:

1. promovimi i imazhit të UPT në procesin e rekrutimit të studentëve nëpërmjet formave të ndryshme, përfshirë organizimin e Ditës së Hapur për UPT.
2. përmirësimi i procesit të orientimit të studentëve dhe këshillimit akademik të tyre. Organizimi i shkollës verore përgatitore për kandidatët, që synojnë të pranohen në vitin e parë të studimeve.
3. vendosja e kriterëve specifike në hyrje me pikësnyim seleksionimin e kandidatëve me karakteristikat më të mira dhe në përshtatje me programet përkatës të studimit.
4. stimulimi me bursa apo reduktim pagese shkollimi për kandidatët cilësorë të maturës shtetërore.

#### **IV.7 Fuqizimi i nismave mbështetëse për të ndihmuar suksesin profesional dhe futjen e të diplomuarve në tregun e punës**

Për plotësimin e këtij objektivi UPT synon :

1. krijimin dhe forcimin e lidhjeve të Universitetit me botën e biznesit, qeverinë qendrore dhe atë lokale si dhe me organizata të tjera jofitimprurëse me synim mbështetjen e punësimit të të diplomuarve;
2. zhvillimi i zyrës së karrierës, duke synuar të bëhet burim informimi dhe këshillimi për studentët
3. organizimin e moduleve të veçanta për forcimin e aftësive dhe të njohurive të studentëve për të lehtësuar futjen e tyre në tregun e punës;

4. mbështjetjen për studentët jo vetëm për gjuhë të huaja, por edhe për lëndët ekstrakurrikulare, si dhe për çdo nismë që çon në lehtësimin e punësimit të tyre.
5. organizimin e panairove të punës, në të cilët të inkurajohen kontaktet punëdhënës-punëmarrës për të lehtësuar futjen në tregun e punës të të sapodiplomuarve.

**Tabela e vënies në jetë të procesit të mësimdhënies në UPT**

Ref	Emërtimi	Indikatori	Afati	Struktura përgjegjëse	Mbështetje financiare		Rreziqet
					Njerëzore	Financiare	
IV.1	UPT synon përmirësimin e kulturës së cilësisë në procesin e edukimit nëpërmjet zbatimit të standarteve më të përparuar	<ul style="list-style-type: none"> <li>• % studentëve të anketuar &gt;60% mirë</li> </ul>	2020-2023	DSBC	SSBC& Njësitë bazë	375 000 Lekë	-
IV.2	Reformimi në bazë të rezultateve të të mësuarit dhe me qendër studentin	<ul style="list-style-type: none"> <li>• % e PS me didaktikë inovative &gt;50</li> <li>• % e pedagogëve të trajnuar për didaktikë inov.&gt;30</li> </ul>	2020-2023	DK+përgjegj dep	Përgjegjësit e NjB & koordinatoret e PS  ZvRektor+Ad-ministritator +DK+Dekan Njësitë bazë	30x250 000 Lekë  6x6 250 000 Lekë 2x7 500 000 Lekë	-
IV.3	Vlerësimi periodik i programeve të studimit dhe Akreditimi i tyre	<ul style="list-style-type: none"> <li>• % e studentëve Alumni të anketuar për PS &gt;70 % mirë</li> <li>• Afati i akreditimit jo më pak se 5</li> </ul>	2021-2023	DK & Përgjegjësit e NjB	Njësitë bazë QSBC+Departamenti Rektorat&Admin +IT DK	7 500 000 Lekë  3 750 000 Lekë	-
IV.4	Rritja e cilësisë në praktika profesionale	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Nr i intershiveve në ndërmarrje</li> </ul>	2021-2023	Dekanët	Njësitë kryesore dhe bazë të UPT	-	-

	dhe diversifikimi i tyre	<ul style="list-style-type: none"> <li>Nr i stud/ped. Për drejtim praktike</li> </ul>			Njësitë bazë të UPT	6x6 250 000 Lekë	-
<b>IV.5</b>	<i>Zhvillimi i infrastrukturës digjitale për përmirësimin e edukimit dhe krijimin e oportuniteteve për personelin akademik</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Nr. software të përdorur në PS</li> </ul>	2022-2023	Administr&IT Depart&Administr	DP&IT + Njësitë bazë të UPT	6x3 750 000 Lekë	-

## V MENAXHIMI I KËRKIMIT SHKENCOR

### V.1 Zhvillimi i burimeve njerëzore, i kapaciteteve infrastrukturore dhe financiare në shërbim të kërkimit shkencor dhe shërbimeve në UPT

Plani i veprimeve për arritjen e këtij synimi konsiston në:

- miratimin e një buxheti të dedikuar për kërkimin shkencor në UPT të detajuar deri në nivel njësie bazë ;
- hartimin dhe zbatimin e një plani të detajuar për modernizimin e laboratorëve ekzistues dhe ngritjen e laboratorëve të rinj ;
- hartimin dhe zbatimin e një plani të detajuar për modernizimin e bibliotekave shkencore të fakulteteve;
- rekrutimin dhe trajnimin e kërkuesve të rinj në shërbim të vazhdimësisë së zhvillimit të kërkimit shkencor në të ardhmen.

### V.2 Rritja në sasi dhe cilësi e veprimtarisë kërkimore dhe e shërbimeve në mbështetje të prioriteteve strategjike të zhvillimit të vendit

Plani i veprimeve për arritjen e këtij synimi konsiston në:

- realizimin e studimeve periodike të tendencave të zhvillimit të industrisë me qëllim përcaktimin e prioriteteve të kërkimit shkencor dhe shërbimeve si dhe aftësive të UPT për t'iu përgjigjur atyre;
- ofrimin e ekspertizës në fushat me interes për zhvillimin e vendit;

3. pjesëmarrjen në konceptim dhe realizim projektsh zbatimi;
4. kualifikimin e personelit mbështetës në përvetësimin e aftësive të nevojshme për një bashkëveprim produktiv me sektorin e biznesit;
5. publikimin e kërkimit shkencor dhe punës krijuese të personelit dhe e studentëve të UPT si edhe përhapja e rezultateve të tyre në botën e ndërmarrjes dhe asaj akademike.

### **V.3 Rritja e kontributit të kërkimit shkencor në përmirësimin cilësor të ofertës akademike në të tre ciklet e studimit**

Plani i veprimeve për arritjen e këtij synimi konsiston në:

1. zhvillimin e programeve të studimeve specializuese afatgjata si programe të formimit profesional në fushat inxhinjerieke të realizohet në përputhje me kërkesat e tregut të punës e të ofrojnë njohuri për profesione të veçanta;
2. ofrimin e programeve të studimeve të formimit të vazhduar, si formë e të mësuarit për gjatë gjithë jetës;
3. zhvillimin e qendrueshëm i Studimeve të Doktoratës në çdo njësi kryesore dhe bazë, duke iu referuar përvojës së Institucioneve partnere të huaja nëpërmjet pjesëmarrjes në veprimtari të përbashkëta;
4. organizimin e leksioneve të hapura me pikësymin përhapjen e rezultateve të punës kërkimore të personelit dhe studentëve;
5. nxitjen e mobilitetit të studentëve pranë universiteteve Evropiane në kuadrin e studimeve të tyre universitare për qëndrime deri në një semestër për të përfituar nga experiencat e përparuara të formimit nëpërmjet kërkimit;
6. Angazhimin e studentëve pranë ndërmarrjeve prodhuese dhe institucioneve kërkimore me detyra specifike kërkimore dhe për zgjidhje të problemeve teknike e teknologjike.

### **V.4 Forcimi i rolit të Institutit të Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit si njësi kryesore kërkimore e ekselencës në fushat përkatëse të ekspertizës**

Plani i veprimeve për arritjen e këtij synimi konsiston në:

1. realizimin e monitorimit të pandërprerë të kushteve meteorologjike, hidrologjike dhe sizmike të hapësirës së vendit tonë dhe vlerësimi i burimeve klimatike dhe ujore, duke mos lënë mënjane kontributin në vlerësimin e situatave për dukuritë ekstreme të motit me pasoja për ekonominë e vendit si dhe impaktin që përcjellin ndryshimet klimatike në zhvillimin e qëndrueshëm të vendit apo energjitë alternative;

2. kontrollin, përpunimin dhe arkivimin e informacionit në përputhje me standartet e (Organizata Boterore e Mjedisit – OBM);
3. analizën dhe vlerësimet për kërkesat strategjike të zhvillimit të vendit;
4. përditësimin e stacioneve të monitorimit duke i kthyer ato nga klasike në të automatizuar;
5. publikimin mujor të një buletini informativ – shkencor;
6. ringritjen e dy laboratoreve, përkatësisht të atij të kontrollit për pajisjet hidrometeorologjike dhe të atij të mjedisit për matjet dhe analizat ajër/ujë;
7. përditësimin e “website”-it dhe rikonceptimin e tij sipas një modeli interaktiv;
8. pjesëmarrjen më të gjerë në projektet kombëtare e ndërkombëtare në fushat e ekspertizës së IGJEUM-it;
9. tërheqjen e studentëve në praktika pranë Institutit dhe përfshirjen e tyre më të gjerë në kërkim shkencor.

#### **V.5 Evidentimi dhe përhapja e rezultateve të kërimit shkencor bazë dhe të zbatuar që zhvillohet në UPT**

Plani i veprimeve për arritjen e këtij synimi konsiston në:

1. përmirësimin e cilësisë së publikimeve duke synuar revista ndërkombëtare me faktor impakti sa më të lartë;
2. organizimin e konferencave shkencore nga njësitë përbërëse të UPT minimalisht në bazë 2 vjeçare;
3. pjesëmarrjen në kongrese e konferenca të njohura kombëtare dhe ndërkombëtare me punime cilësore për të afirmuar rolin e UPT si institucion i spikatur kërkimor-shkencor në Shqipëri;
4. organizimin e “Ditës së Inovacionit dhe Kërimit Shkencor”, për promovimin e aktivitetit kërkimor dhe shkencor të UPT dhe universiteteve partnere dhe Konferenca Vjetore Inovacionit dhe Kërimit Shkencor e UPT;
5. botimin e BSHT në shqip dhe në një nga pesë gjuhët e BE;
6. botimin e rezultateve të kërimit të realizuar në UPT;
7. botimin e punimeve të disertacioneve të doktoratave të mbrojtura dhe abstraktet përkatëse në një nga të pesë gjuhët e Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht, italisht;
8. botimin e abstrakteve përkatëse të punimeve të diplomave të ciklit të dytë dhe të tretë, të mbrojtura dhe në një nga të pesë gjuhët e Bashkimit Evropian.



## V.6 Rritja e kontributit të kërkimit shkencor, veprimtarive krijuese dhe ekspertizës në fushat përkatëse inxhinierike në sigurimin e të ardhurave suplementare për UPT

Plani i veprimeve për arritjen e këtij synimi konsiston në:

1. zgjerimi i bashkëpunimit me institucionet homologe dhe me sektorin privat në trojet shqipfolëse duke e konkretizuar në projekte e studime të përbashkëta;
2. Kualifikime shkencore dhe shkëmbime të eksperiencave të stafit akademik dhe kërkimor-shkencor në institucionet dhe universitetet partnere.

**Tabela e vënies në jetë të menaxhimit të kërkimit shkencor në UPT**

Ref.	Emërtimi	Indikatori	Afati	Struktura përgjegjëse	Mbështetja financiare		Rreziqet
					Njerëzore	Financiare	
V.1	Buxhet i detajuar për KSH	Përqindja e Buxhetit për KSH	Çdo vit akademik	Rektorati, Njësitë Kryesore	Departamentet	6% vitin e I dhe me rritje vjetore 1% për të arritur në 10%	Kufizimet buxhetore
V.2	Studime periodike të tregut.	Numri i studimeve të tregut	Çdo dy vjet	Njësitë Kryesore, Zyra e karrierës	Departamentet	625 000 Lekë / në vit	-
	Projekte	Pjesmarrja në projekte (nr. i kontratave të bashkëpunimit)	2019 – 2023	Depart.	Departamentet	5 000 000 Lekë në vitin I, me rritje vjetore 20% për të arritur në 10 000 000 Lekë / vit	Kufizimet buxhetore
V.3	Studime doktorale jashtë vendit	Numri i studentëve doktorant sipas njësite kryesore	2019 – 2023	Depart.	Departamentet	6 250 000 Lekë/vit 1 student /NJK (6 muaj në vit)	Kufizimet buxhetore
	Studime të specializuara	Numri i studentëve të ciklit të Dytë të përfshirë në projekte kërkimore	2019 – 2023	Depart.	Departamentet	2 500 000 Lekë / vit	Kufizimet buxhetore
V.5	Cilësia e publikimeve	Numri i publikimeve në	2019 – 2023	Depart.	Departamentet	2 000 000 Lekë / vit	Kufizimet buxhetore / vepr.

		konferenca, simpoziume dhe revistat					kufizuar shkencore
	Pjesmarrja në konferenca	Numri i konferenca ve për NJ.K	2019 – 2023	Depart.	Departamentet	15 000 000 Lekë / vit me rritje vjetore 30% për të arritur në 50 000 000 Lekë/vit	Kufizimet buxhetore / vepr. kufizuar shkencore
<b>V.6</b>	Bashkëpunimi me institucione analoge	Numri i bashkpunimeve të financuara nga biznesi	2019 – 2023	Rektorati, Dekanatet	Departamentet	50 000 000 Lekë/ vit me rritje vjetore 10%	Kufizimet buxhetore

## VI MENAXHIMI I JETËS STUDENTORE NË UPT

### VI.1 Përmirësimi i cilësisë së jetës studentore duke synuar rritjen e cilësisë së shërbimeve si dhe zbatimin e një politike gjithpërfshirëse si në vendimarrje ashtu dhe në zhvillimin shoqëror për studentët

Plani i veprimeve për arritjen e këtij synimi konsiston në:

1. krijimin e një infrastrukture të përshtatshme studimi për studentët në çdo njësi kryesore (e pajisur me komputera, shërbim interneti, fotokopje, printer);
2. krijimin e një infrastrukture të përshtatshme për studentët që ofron shërbime kancelarie / gastronomike.

### VI.2 Përmirësimi i cilësisë së sistemit të menaxhimit të informacionit në nivel institucional

Plani i veprimeve për arritjen e këtij synimi konsiston në:

1. organizimin e veprimtarive për të përcjellë informacion tek maturantët për kriteret e pranimit në UPT si dhe për programet e studimit që ofron UPT-ja;
2. riorganizimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës;
3. krijimin e Alumni Association / Shoqata e të Diplomuarve.

### VI.3 Funkionimi dhe përdorimi i kartës së studentit

Plani i veprimeve për arritjen e këtij synimi konsiston në:

1. organizimin e punës përgatitore për hartimin e marrëveshjes së bashkëpunimit me Bashkinë e Tiranës për ofrimin e shërbimit të kartës së studentit, studentëve të UPT-së.

#### VI.4 Përmirësimi dhe zbatimi i një politikë gjithpërfshirëse si në vendimarrje ashtu edhe në zhvillimin e veprimtarisë shoqërore

Plani i veprimeve për arritjen e këtij synimi konsiston në:

1. mbështetjen e studentëve në riorganizimin e Këshillit Studentor dhe hartimin e Statutit të Ri ;
2. organizimin e zgjedhjeve të Këshillit Studentor në nivel njësie kryesore dhe institucional;
3. miratimin e një plani financiar për zhvillimin dhe realizimin e veprimtarive shoqërore.

**Tabela e vënies në jetë të menaxhimit të jetës studentore**

Ref	Emërtimi	Indikatori	Afati	Struktura përgjegjëse	Mbështetje financiare		Rreziqet
					Njerëzore	Financiare	
VI.1	<b>Cilësisë e jetës studentore</b>						
	1. Rritje e hapësirave bibliotekare.	Vënia në funksionim e sallave të reja multimediale.	2023	Rektorati i UPT.	Dekanatet e FAU, FIMIF, FTIdhe FIE. DSHB, Sektori IM dhe DE.	139 462 000 Lekë	Mosrealizimi në kohë i procedurave për arsye të kornizës ligjore
	2. Plotësimi me hapësira shërbimi	Ambiente shërbimi kancelarie për çdo njësi.	2023	Administratori i UPT.	Njësitë Kryesore Sektori IM, DSHB, DE.	5 000 000 Lekë / vit	Mosrealizimi në kohë i procedurave për arsye të kornizës ligjore
	3. Infrastruktura për shërbime gastronomike	Shtimi i shërbimit të mensës në UPT.	2023	Rektorati i UPT.	Njësitë kryesore. DSHB, Sektori IM dhe DE.	9 970 000 Lekë.	Mosrealizimi në kohë i procedurave për arsye të kornizës ligjore. Vonesat ligjore në marrjen e lejeve.

VI.2	<b>Sistemi i informimit</b>						
	1. Faqja e internetit të UPT-së	Numri i përdoruesve.	çdo vit.	Rektorati i UPT.	Spektori i Komunikimit me Publikun (Këshillimi i Karrierës + Alumni).	-	-
	2. Informimi i maturantëve	Numri i aktivitetëve / materialeve informuese.	çdo vit.	Rektorati i UPT.	Spektori i Komunikimit me Publikun.	500 000 Lekë / vit.	-
	3. Organizimi i Sektorit të Komunikimit me Publikun (Këshillimi i Karrierës + Alumni)	Miratimi i organikës dhe punësimi i personelit.	2019	Senati Akademik, Bordi i Adminstrimit	Rektorati i UPT.	2 232 000 Lekë / vit.	-
VI.3	<b>Funksionim i dhe përdorimi i kartës së studentit</b>						
	1. Përdorimi i kartës së studentëve për shërbimet që universiteti ofron studentëve.	Nr. shërbimeve të ofruara nga UPT.	2019 - 2020	Administratori	Sekretaritetë mësimore të Njësive Kryesore, DSHB.	-	Korniza ligjore.
VI.4	<b>Politikë gjithpërfshirëse</b>						
	1. Zgjedhja e Këshillit Studentor në nivel njësie kryesore.	Miratimi i Rregullores së zgjedhjeve.	2019	Senati Akademik.	Studentët, DJ e UPT.	-	-
	2. Riorganizimi i Këshillit Studentor.	Miratimi i Statutit të Këshillit Studentor.	2019	Këshilli Studentor	Studentët.	-	-

	3. Veprimtari shoqërore.	Nr. i veprimtarive të KS.	Çdo vit.	Rektorati I UPT.	Këshillat studentorë të njësive kryesore. Njësitë kryesore. DSHB, DE.	2 000 000 Lekë në vit.	
--	--------------------------	---------------------------	----------	------------------	---	------------------------	--

Strategjia e UPT miratohet me datë 01.11.2019 dhe hyn në fuqi menjëherë.